



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 3, datë 28 .02. 2013

**PËR  
“VENDOSJEN E BUSTIT TË ISH DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË,  
Z. SABRI GODO”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 8/VII gërma “a, nenit 10 pika 3/I, shkronja “ë” dhe nenit 32, gërma “m” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin për vendosjen e bustit të ish deputetit të Kuvendit të Shqipërisë në dy legjislatura, një ndër politikanët më të njohur në Shqipëri, shkrimtarit dhe skenaristit, z. Sabri Godo, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë vendosjen e bustit të një ndër politikanëve më të njohur në Shqipëri, ish deputetit të Kuvendit të Shqipërisë në dy legjislatura, shkrimtarit dhe skenaristit z. Sabri Godo, në lulishten përpara Parlamentit, ngjitur me shëtitoren “Murat Toptani”, nga Akademia e Shkencave, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**Niazi KOSOVRASTI**